

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“POWER SOFT INNOVATIONS” shpk

Sot, më 24.02.2025 ,themeluesit ,

1. Sirius Lasku, atësia Naun, shtetase shqiptare me numër personal identifikimi J36013037F, e datëlindjes 13.10.1993, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë; madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar
2. Theodor Koxhoni, atësia Harito, shtetas shqiptar, me numër personal identifikimi J20809028U, i datëlindjes 09.08.1992, lindur në Nivan, Gjirokastrë dhe banues në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kanë krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtme ,

Neni 1

Themelimi

- 1) Emri i shoqërisë është “Power Soft Innovations ” shpk
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar’ në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

1. Zhvillim, implementim dhe mirembajtje të sistemeve dhe programeve në fushën e teknologjisë së informacionit. Projektim, ndërtim dhe mirembajtje në fushën e telekomunikacionit si rrjete WAN/LAN, sisteme sigurie Web-site etj. Shërbim akses interneti. Shërbime konsulence dhe trajnime profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit
2. Tregti, eksport-import, furnizime, instalime dhe mirembajtje të pajisjeve elektronike, informatike, audiovizive, të aparturave teknike të telekomunikacionit, të laboratoreve didaktik, kërkimor e shkencore.
3. Shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave; d. Tregti elektronik (e-commerce); e. Konsulencë në teknologjinë e informacionit në sektorin financiar dhe bankar; f. Ndërmjetësim dhe shërbime të tjera ndihmëse për aktivitet financiar të licensuar; g. Pagesa elektronike dhe procesimi i pagesave elektronike. Regjistrimi dhe Administrimi i Emrave dhe Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”
4. Instalime elektrike, instalime sistemesh sigurie, instalime sistemesh automatizimi (Smart), instalim dhe mirembajtje të impjanteve të karikimit të makinave elektrike.

5. Import-eksporti, shitje me shumice dhe pakice, si dhe shërbimi dhe mirëmbajtja e gjeneratoreve të ndryshëm të energjise, paneleve solar, paisjeve mjekesore dhe spitalore, paisjeve ajrit të kondicionuar, ventilimi, paisjeve të back-up dhe baterive. Import - eksport, me shumice e pakice të vajrave lubrifikant dhe pjeseve të këmbimit për çdo lloj motori dhe fuqie, të pajisjeve elektronike, elektro-shtepiake, impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV, i pajisjeve dhe sistemeve për mbrojtjen nga zjarri dhe sistemeve të tjera sigurimse dhe detektimi
6. Ofrimi i shërbimeve të konsulencës dhe ndërmjetësimit për individët dhe kompanitë në shitblerjen e automjeteve, duke përfshirë edhe përfaqësimin dhe ndërmjetësimin në marrëveshjet ndërkombëtare të shitblerjes. Ofrimi i shërbimeve të dhënies me qira dhe leasing për automjete dhe makineri të ndryshme motorike për përdorim afatshkurtër dhe afatgjatë.
7. Import Eksport, instalim, konfigurim, komisionim dhe mirëmbajtje për Mallra, Sistemet dhe paisjet me Përdorim të Dyfishtë civil dhe ushtarak, sistemet e Integruara të ICT, CCTV, Sigurisë Kibernetike, Radareve, Sistemet e Navigimit, Sistemet e Komunikimit, Sistemet e Radio, MW dhe Meteorologjisë.
8. Shërbime të konsulencës financiare. Shërbime të keshillimit financiar, shërbime kontabiliteti. Shërbime të administrimit të taksave dhe shërbime të tjera administrative dhe organizative. Shërbime të regjistrimit të biznesit. Shërbime të regjistrimit fillestar dhe ndryshime të tjera në regjistrin tregtar. Shërbime të tjera profesionale, hartim plani biznesi për shoqëri të reja apo ekzistuese në fushën e trajnimit profesional dhe diversifikimit të biznesit, shërbime të rekrutimit të trajnimit të punonjesve dhe shërbime të veprimtari të tjera të ngjashme.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 4

Selia

1. Shoqëria e ka selinë në: Rruga e "Qemal Stafa", nr 182/1 godinë private, pas Lincoln Center, Tiranë.
2. Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (Një qind mijë) Lekë dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku themelues Sirius Lasku, zotërues e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme me 80,000 (tetëdhjetë mijë) Lekë, që përben 80 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku themelues Theodor Koxhoni, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme me 20,000 (njëzetë mijë) Lekë, që përben 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

Neni 6
Administratori

Administratori i shoqërisë emërohet Theodor Koxhoni, atësia Harito, shtetas shqiptar, me numër personal identifikimi J20809028U, i datëlindjes 09.08.1992, lindur në Nivën, Gjirokastrë dhe banues në Tiranë; me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit 24.02.2025 deri më 24.02.2030.

Neni 7
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Neni 8
Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posacme të njohura nga ligji.

O R T A K Ë T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“POWER SOFT INNOVATIONS” shpk

Sirius Lasku

SIRIUS LASKU

Theodor Koxhoni

THEODOR KOXHONI